



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:3

P r o c e s v e r b a l

Tipi i mbledhjes: Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Data e mbajtjes: 13.06.2025 Ora: 09:45

Vendi i takimit: Salla e Kuvendit Komunal

Mbledhjen e kryesoi: Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj

Procesmbajtës: Skender Hasangjekaj, Koordinator i KKSB-së

Anëtarët e Këshillit:

1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;
2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;
3. Shemsedin Zymberaj, Bashkësia Islame;
4. Don Alfred Sökoli, Kisha Katolike,
5. Jerej Nebojša Sekulliç, Kisha Ortodokse,
6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;
7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;
8. Adnan Ramić, Komuniteti Boshnjak;
9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;
10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;
11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;
12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;
13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;
14. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;
15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;
16. Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc;
17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;
18. Blendineta Shatri, EVSB;
19. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;
20. Almina Eqo, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;
21. Blendor Isufaj, KVRL;
22. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";
23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;
24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe
25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.

	<p>Mungojnë: Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike, Jerej Nebojsa Sekuliq, kisha Ortodokse Adnan Ramiq, Komuniteti Boshnjak Gëzim Ademaj, KI.SP, Banjë Blendor Isufaj, KVRL Almina Ego, ZLK Armir Arifaj, SH.K.K Burgu i Dubraves Komuniteti i Biznesit</p> <p>Pjesëmarrës tjerë: Francesco Vasco, KFOR, plus dy antar tjer Dardan Duraku, MPB Arbnor Hashani, FSK Haki Belaj, NJPZSH Istog Astrit Hajrizaj, DBZHR Rifat Dreshaj, DKR APK Endrit Mehmetaj, RTV Fontana Mehmed Qeman, përkthyes, Komuna Istog Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit, Komuna Istog Lirije Demiri, Komuna Istog</p>
<p style="text-align: center;">Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Rendit të ditës, 2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit 3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK 4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Sh.K.K “Burgu i Dubraves”, Perfaqsuës të komuniteteve etj.) 5. Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduar, prodhim i pa kontrolluar (raporti i inspektorit sanitar nga mbledhja e kaluar) 6. Mbrojtja e pyjeve nga zjarret Mirmbajtja e rrugëve malore 7. Të ndryshme 	

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Përshëndet të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe gjithë të prënishmit, në veçanti perfaqësues të Institucioneve qendrore dhe rajonale. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Konstatohet se nga 24 anëtar të KKSB-së, të prënishëm janë 17 anëtar dhe kemi kuorum për të vazhduar mbledhjen. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës pos këtyre që i lajmroj. Me që nuk ka propozime tjera, miratohet rendi i ditës unanimisht.

2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pyet anëtarët e KKSB-së të pranishëm në mbledhjen e kaluar a ka dikush vrejthe në ekstraktin e procesverbalit. Me që nuk ka vrejthe, miratohet ekstrakti i procesverbalit unanimisht. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon zv. komandantit të Policisë.

Tog. Ramadan Gashi, Shef i Njësisë së Hetimeve të St. Policisë Istog - Situata në zonën e përgjegjësisë është e qetë dhe stabile. Stacioni i Policisë vazhdon të punojë në bazë të Planeve Operative si dhe në bazë të Planeve dhe urdhërave nga niveli qendror dhe nga Komanda regjionale. Në vazhdim do të paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

- Raste të inicuar, kemi ngritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024
- vepra (kundervajtje dhe penale), kemi ngritje për 10 raste më shumë
- Zbulueshmëria e 70.8% e rasteve në përgjithësi
- Aksidente trafiku, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ka rritje 100%, që është shqetsuese
- Në fillim të muajit kemi pas 1 tentim vrasje në Vrellë, në një ndermarrje kanë qënë 3 punëtor njëri nga ta është i arrestuar dhe është në arrest shtepiak për rastin vrasje në tentativë
- Sa ju përket urdhërësive nga Prokuroria apo Gjykata për ndalesa-arrestime aktive janë vetëm 4, për arsye se të kërkuarit gjinden jashtë shtetit
- Zbulueshmëria e rasteve në krahasim me të njëjtën kohë të vitit të kaluar është 76% që është shumë më e madhe
- Dhuna në familje kemi besueshmëri më të madhe në Polici dhe nuk hezitohet të paraqiten rastet
- Falë punës së Policisë në komunitet në Shkollë e kemi gjendjen shumë të mirë në krahasim me vitin e kaluar, kur ka të bëjë me veprat kryesisht që kryhen nga nxënësit
- Këtë muaj kemi Plan Operativ në ndalimin e ndertimit të staneve në bjeshkë dhe atë kryesisht në Parkun Nacional me kërkesë të nivelit Qendror

Shqetsuese per ne dhe besoj edhe për qytetarët janë qent endacak por Policia këtu ka kompetenca të kufizuara dhe ky shqetsim për kafshime të qytetarve nuk është vetëm i Istogut por i krejt Kosovës.

U njoftova se ka pas shqetsim të Komunitetit Serb në Lubozhdë, lidhur me gërmimet e që komuniteti nuk ka qen i njoftuar. Rreshteri i Sektorit ka ndermarr masa dhe gërmimet kanë të bëjnë me kërkimet Arkeologjike në atë rajon e të cilat e kanë lejen nga niveli Qendror.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj Togerin e Policisë dhe hap debatin. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb- pyetje për togerin e Policisë, a kanë qen të njoftuar pronarët e shtepive para se të fillojn gërmimet.

Tog. Ramadan Gashi, Shef i Njesisë së Hetimeve i St. Policisë Istog - para se të fillojn punimet-hetimet nuk kemi qen të njoftuar me aktivitetin, në nderkoh Policia i ka kontaktuar gjithë pronaret e pronave dhe kemi konstatuar se nuk cenohet prona e askujna dhe pas bisedave-njoftimeve të komunitetit nuk ka shqetsime në komunitet. Pas gërmimit nese gjindet diçka ather ndermirren masa nga niveli Qendror për vazhdimsin e aktivitetit dhe statusin e pronës, nese jo gjithçka kthehet në gjendjen e më parshme dhe nuk mbetet asgjë e dëmtuar.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pyetje per togerin Gashi, ndertimet e stanijeve në bjeshkë a janë me leje, a ka Policia ndonjë informat dhe a ndermerr ndonjë veprim lidhur me këtë aktivitet dhe pyetja e dytë a ka bër Policia ndonjë kontroll të kombibusve dhe autobusëve që transportojn nxënës dhe udhtar ndonë kontroll teknike të dhe a kerkon çertifikat të mjekut të ngasësve të autobusëve.

Tog. Ramadan Gashi, Shef i Njesisë së Hetimeve i St. Policisë Istog - ndertimet pa leje janë shqetsuese dhe uzurpim i pronave shtetnore në bjeshkë, kemio kontakte të vazhdueshme me Prokurorin Themelore në Pejë, veprimet i ndermarrim në bashkëpunim me Prokurorin dhe bëjm identifikimin e pronarit, gjendjen faktike të stanit dhe madhësin e pronës së rrethuar të njëjtat i dorzojm në Prokurori dhe veprimet tjera janë të Prokurorisë. Gjendja bëhet e komplikuar me që me Ligjë çdo qytetar ka të drejtën e aplikimit në Agjencionin e Pyjeve, nuk kemi informata që janë pais me leje ndertimi, mirëpo qytetari arsyetohet se kamë apliku për leje dhe e merr pergjegjësini personalisht. Ne ju kemi dhën vrejte-ju kemi bër thirrje permes mediave që mos të fillohet me ndertim pa u paisur me leje.

Sa i perket pyetjes së dytë, Policia nuk jep licenca, gjendja teknike e kombibusve dhe autobusve mund edhe mos të jetë e knaqshme por janë këto të cilat i posedojn dhe nese e largojm nga komunikacioni për një arsye të vogel krijojm problemin tjetër transportin e fëmijve të cilet nuk mund të vijojn mësimin.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar -lidhur me informate që aksidentet në trafik janë rritur 100% më shqetsoj, pyetje a bëni ndonjë analiz, faktet që sjellin tek këto incidente a ka lokacione kritike apo cilat janë shkaqet .

Tog. Ramadan Gashi, Shef i Njesisë së Hetimeve i St. Policisë Istog -kur e ceka në raport 100% rritje është shqetsuese, vertet është shqetsuese krahasuar me periudhen e njëjt të vitit të kaluar si perqindje por si shifer vitin e kaluar kanë qen 13 ndersa këtë vit janë 26 që si numer nuk është i madhë. Ka arsye të ndryshme, analizat bëhen ditore si shkaqe janë numri tejet i madhë i automjeteve në trafik, me mënyren e marrjes së patent shoferve dhe shumë rregulla tjera. Policia është 24 orë në detyr dhe në

perciellje të gjendjes. Ndermarrja e masave nëpër vitë ndoshta janë dhjetfish të rritura dhe mundohemi të mbajm siguri në trafik, por edhe kur është aksidenti me dëme të vogla materiale evidentohet si aksident dhe kjo e rrit perqindjen e aksidenteve.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës -Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë kalojm në pikën e katert të rendit të ditës.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës, Perfaqësuesit e KFOR-it, FSK-së, Arsimit etj fjala është për ju.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pas perfundimit të tregut që ka qen dje, sot sihen mbeturina në rrug, kush merret me to dhe a ka mundsi të krijohet një vend i posaçem për shitsit ambulantor.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - kjo pyetje dhe ky diskutim mund të bëhet në pikën të ndryshme. A ka kush ndonjë çështje nga institucionet që përmenden në pikën e katert të rendit të ditës.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKS-së - me datë 02-03.06 OSBE-ja në bashkëpunim me MPB-në, gjegjësisht Departamentin e Sigurisë Publike, ka organizuar seminar dy ditor me Koordinatorët e KKS-ve në Hotel Dukagjin në Pejë për krejt Kosovën. Tema ishte funksionimet e KKS-ve, shqetsimet e ngritura temat me rëndsi për sigurinë e përgjithëshme etj, njëheri OSBE-ja na ka njoftuar se këtë vit e perfundojnë monitorimin e KKS-ve në përjashtim të Komunave në veri të Kosovës të cilat janë në formim e sipër. Shqetsim për nivel Kosove ka qen braktisja e Shkollave që gjat vitit 2023-2024 rreth 1600 nxënës e kanë braktisur Shkollën dhe se nga Drejtorit e Arsimit këto statistika mshefen për të mos dal keq si institucion.

Pyetja ime është lidhur me këtë për Drejtorin e Arsimit si qëndron gjendja në Komunën tonë dhe cilat janë arsyt e braktisjes së Shkollës.

Naim Behluli, Drejtor i DKA-së- kemi statistika të sakta dhe si institucion nuk i mshefim sepse kjo terthorazi e ndihmon braktisjen e mëtutjeshme.

Në Komunën tonë kemi 11 nxënës që e kanë braktisur Shkollën numri më i madh i këtyre janë të komuniteteve pakic për arsye të levizjeve në qytete tjera apo përndim por që nuk kemi informatë kthyese se ka levizin. Ndersa nga komuniteti shumic janë migrim jashtë vendit. Në krahasim me komunat tjera jemi më mirë sepse funksionojn këshillat dhe komisioni për braktisjen e Shkollave.

Tetar ARSIM Selimi FSK- si institucion jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe vlersimi i jon është se situata në Komunën e Istogut është e qet dhe stabile.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas - Pyetje për rrugën Haki Hoti në Dubravë tek Shkollën ende e pa asfaltuar, kanë nderhy me vetem do zhavor.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - kjo pyetje më shumë do të duhej adresuar në Drejtorin përkatës, besoj që si kjo rrugë she shumë tjera janë në kuader të trajtimit dhe tani jemi në fazën e degjimeve publike lidhur me projektimin buxhetor afatmesëm dhe do të ishte mirë që këto tema të trajtohen edhe në këto evente dhe të marrin epilogun e duhur. Këtë rrugë e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e kaluar të K.Komunal.

5. Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduara, prodhim i pa kontrolluar

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - pjesa e mbetur nga mbledhja e kaluar referim nga Inspektori Sanitar.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së - inspektori Sanitar gjindet në pushim të lehonis andaj nuk ka mund të jet prezente dhe e njëjta nuk ka zavendsues, andaj kjo tem duhet shtyr.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - shumë keq sepse është tem me rendsi të veçant dhe kerkoj që për takimin e radhes të sigurohet prezenca dhe raportimi i Inspektorit Sanitar. Athere kalojm në piken e gjashtë të rendit të dites.

6. Mbrojtja e pyjeve nga zjarret

Mirëmbajtja e rrugve malore

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - ftoj inspektorin e preventives z. Haki Belaj që ta paraqes një raport

Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - me që jemi para një sezone që do të jet tejet e nxehtë dhe me mungesa të të reshurave atmosferike. Duhet të jemi tejet përgjegjës gjithë qytetaret e Komunës në ndermarrjen e masave preventive për parandalimin e zjarreve dhe të zbatojm udhëzimet për mos ndezjen e zjarreve në hapsira. Sa ju përket institucioneve duhet që të kryejm të gjith detyrimet dhe më lejoni të theksoj se Agjencioni i Pyjeve e ka detyr parsore si menaxhimin poashtu edhe mbrojtjen qoft nga prerjet poashtu edhe nga zjarret , ndersa ne si NJPZSH jemi mbeshtetes në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Ne e kemi bër një shkres zyrtare Agjencionit për masat të cilat duhet të ndermarrin në mbrojtjen e Pyjeve nga zjarri dhe njëkohisht i kemi informu me kapacitetet e limituara si në teknik poashtu edhe në personel. Tani do hyjm edhe në fazen e fushates së korrjeshirjes e cila do të jet mjaft sfiduese në këto temperatura, andaj ftoj që të gjithë që të zbatojn kompetencat e veta dhe të jen të ndergjegjshëm në zbatimin e tyre. Shfrytzoj rastin që të bëj apel tek bujqit dhe tek Drejtoria e Bujqësisë që fushat e korrura të lavrohen menjëhere për të evituar zjarret fushore dhe përhapjen e tyre duke rrezikuar edhe objekte banimi etj.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj z. Haki Belaj dhe fjalën ja kaloj z. Rifat Dreshaj nga Agjencioni i pyjeve.

Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës - si Agjencion i kemi bër përgatitjet për mbrojtje nga zjarret dhe për momentin nuk kemi këso problemesh, ballafaqohemi me prerjet ilegale por edhe këto kanë rënje të dukshme.

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit të Bujqësisë - sa i përket mirëmbajtjes së rrugve malore jemi për momentin duke punuar në tri akse rrugore, të cilat përpos krijimit të kushteve të mira për fermer dhe vizitor të bjeshtëve krijojnë edhe kushte optimale në aspektin e sigurisë duke ju ofruar kushte qarkullimi si Policis, KFOR-it dhe në raste emergjente qoftë zjarrëfikësve qoft autoambulancave. Në të kalueren sa ka qen sektori i Pylltaris në kuader të Drejtyoratit kemi pas bashkëpunim të mirë me zjarrëfikës, Polici dhe institucione tjera dhe shpresoj se edhe tani në kuader të përgjegjësive tona të vazhdojm bashkëpunimin e mirë. Sa i përket korrjeshirjeve kemi formuar shtabin dhe përgatitjet lidhur me këtë fushat.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj Drejtorin dhe parafolsit dhe hapi debatin lidhur me raportet gjegjësisht temen

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar - a ka ndonjë struktur e veçant në Komunë e cila është përgjegjëse që merret me planifikimin dhe masat e parapara për parandalimin e zjarreve. Ndersa sa i perket rrugve malore çka nënkuptojm me termin rrug malore a janë vetëm ato kah qarkullojnë automjetet apo edhe rrugët kah levizin këmbësorët apo turistët sepse të njëjtat pothuajse janë mbyllë, a janë të perfhira edhe këto për hapjen e tyre.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së - Në kuader të Administratës komunale funksionon Drejtoria për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila bazuar në Legjislacionin për menaxhimin e fatkeqsive natyrore është përgjegjëse për planin e Vlersimit të rrezikut dhe hartimin e Planit Operativ Emergjent, ku perfatkeqsi të ndryshme parashihen institucionet bartëse dhe institucionet mbështetse. Nga referimet e zyrtarve ju patet mundësi ta verejini se sa ju perket zjarreve i kemi tri institucione që reagojnë por u tha kush është bartësi i përgjegjës. Kur sektori i Pylltarisë ishte pjesë e Drejtoratit të Bujqësisë, Nga niveli qendror gjegjësisht nga Ministria e Bujqësisë për tërë territorin e Kosovës i prenonte një numer Zjarrfikësish, në Istog kanë qënë kater, si vrojtues të pyjeve për të kryer detyrën e parandalimit dhe lajmërimit të hershëm në raste zjarresh. Sa i perket NJPZSH-së në Istog janë nën menaxhimin e Drejtorisë por janë staf i AME-së dhe kapacitetet janë të limituara si në personel (10 zjarrfikës) poashtu edhe në teknik. Pa marrëparasysh Ligjin për vetqeverisje Lkale dhe legjislacionin në fuqi ku parashihen shumë obligime gjegjësisht detyrime Komunave, niveli Qendror çdo ditë e më shumë është duke marrë kompetencat por që legjislacioni mbetet i njëjt si detyrime të Komunave. Ligji i fatkeqsive natyrore e obligon çdo qytetar të ndermerr masat për mbrojtje nga fatkeqsit natyrore dhe fatkeqsit tjera. Dalja e turistëve apo qytetarëve për piknik në bjeshkë duhet menaxhuar ku dhe si dhezin zjarrmije dhe këtë do të duhej ta rregulloj dhe ta përciell Agjencioni i Pylltarisë si përgjegjës për Pyjet dhe bartës e reagimit eventual në zjarre malore, andaj nëse nuk e kanë bërë deri me tani do të duhej të marrin masa për sensibilizimin e opinjonit dhe parandalimin e ndezjes së zjarreve në vende të hapura. Gjitha parashikimet hidrometeorologjike janë që ky vit do të jetë tejet i nxehtë dhe i thatë andaj rreziku nga zjarret është potencial, kur kësaj i shtohet edhe mungesa e ujit në regjionin e mbivades si e quejm ne por jo vetëm dhe kërkesat e shumta për furnizim me uj, e që në të kaluarën e kemi bërë me zjarrfikës të cilët janë në ndërrim, këtë vit duhet menduar dhe kërkuar një zgjidhje tjetër ose të angazhohet staf si punë shtesë në kohën e lirë të tij ose të ngarkohet institucion tjetër. Numri i kufizuar i Zjarrfikësve nuk është problem vetëm i Istogut por i Krejt Kosovës anadaj në takimin e OSBES-së në Pejë Drejtoresha e Emergjencave e Prizrenit e ngrit si çështje me që ishin të Pranishim zyrtar nga MPB-ja edhe pse jo nga AME-ja, por me kërkesë që tju transmetohet ky shqetsim i Komunave.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar - pikrisht këtu ishte fokusimi i pyetjes sime tek vrojtimi, parandalimi dhe lajmërimi i hershëm, a do të thotë se po egzistojka ky sherbim. Është e rëndësishme që qytetarët të shohin se po egzistojka ky sherbim dhe kanë tjetër qasje kur janë të vetdijshëm se këta zyrtar janë prezent.

Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - Agjencioni Pyjor e ka Planin e Menaxhimit të Pyjeve, e në kuader të saj edhe Planin e mbrojtjes nga zjarret. Aktivizimi i hershëm

i ketyre Planeve është i domosdoshem dhe është preventiv dhe sukses i reagimit. Do të ket vizita sbashku me Policin dhe Agjencionin e Pylltaris në senzibilizimin e opinjonit dhe ne si Drejtori kemi shpall edhe njoftime në mediat lokale.

Zeqir Mehmetaj, Radiofontana - Drejtori i Buqësis i pershendeti edhe ndegjuesit, më lejoni që të sqarohem se jemi në debat të drejtpërdrejt dhe kemi me mijra shiques-ndegjues që janë duke shtruar pyetje të ndryshme rreth temave, por që nuk po preferoj të inkuadrohen dhe të paraqesim pyetjet e tyre. Duke pas parasysh këtë fakt po kerkoj që të jemi ma rentabil me kohen dhe me pyetjet e mos të marrim disa here fjalcn. Pyetje per Haki Belaj sot duke shkuar në një intervenim një autobot e zjarrëfikësve menxi u ngjit tek Trofta në perpjetze, si duket është "oldtimer", do të ishte mirë të investohet në teknik të zjarrëfikësve edhe psc mund të ipet pergjigje se nuk është kompetenc e pushtetit lokal, sfundmi është interes i qytetarve të lihet një rrugë pa u shtruar asfaltt dhe të blihet një kamion.

Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës - po pajtohem se do të ishte mirë të jemi ma konkret dhe më rentabil me kohen por është e drejt e anëtarve të shtrojn pyetjet dhe shqetsimet.

Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës - sa i perket monitorimit, pylltarët janë 24orë në teren dhe kemi hapsir për parandalim, sidomos vikendeve kur ka fluks më të madhë të vizitorve. Në rastë të zjarreve ne tentojm të ndermarrim masa dhe të ndalim zjarrin mirpo nese është i permasave të mëdha ne e lajmrojm rastin sepse nuk kemi kapacitete.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pyetje për Inspektorin Haki Belaj, ndezja e zjarreve sidomos nga fermerët e qet rrotoballen e kalbët dhe e dhezë e ndot ambientin dhe e pengon gjithë fshatin, çfar masash ndermerrni në këto raste.

Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - zjarret në ambiente të hapura janë të ndaluara, mvarsisht nga niveli dhe shkaktimi i dëmit mund të ndermirren masa të ndryshme, deri tek ajo si veper penale nëse karakteri dhe permasa e zjarrit është cenim i siguris dhe rrezik i pergjithshëm.

Skender Hasangjekaj, koordinator i KKSB-së - Zeqiri e ngriti një çeshtje me vendsi gjendjen teknike të autobotave të Zjarrëfikësve. Shfrytzoj rastin ti falenderoj KFOR-in Italian per perkrahje dhe donacione në NJPZSH. Gjat dhurimit të një donacioni ju drejtova Komandantit kur i shiqonte paisjet dhe autotekniken thash pyete Komandantin e njësis a është me mosh ma i vjeter aj apo kamioni MAN. Vertet Komuna nuk ka buxhet per ta bler të ri andaj shfrytzoj rastin që së bashku me Zeqirin ta gjejm ndonjë OJQ në perendim e cila do ja dhuronte Brigades një autobot e cila është në gjendje teknike shum të mirë edhe pse i ka mbi 10vite kur është donacion lejohet të zhdoganohet dhe regjistrohet.

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit të Buqësis- desha ti pergjigjem pyetjes së Profesorit idhur me mirmbajtjen e rrugve. Vetem rrugët per qarkullim me automjete janë të perfshira në këtë kontratë por jo edhe rrugët apo shtigjet për këmbësor-turistë.

7. Të ndryshme

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - pyet a ka dikush të ngris ndonjë çeshtje jashë rendit të ditës.

Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - fluksi i bashkatdhetarve ka filluar të vij në Istog dhe pritet të jetë më intenziv në ditët në vijim, por do të ketë edhe turist që vizitojn bjeshkët tona me që dita ditës paraqesin atrakcion për vizitor. Shfaqja e gjarpërinjve helmues tani më është bërë shqetsuese, pyetja është sa jemi të gatshëm për tju ofruar ndihmën e nevojshme qytetarve- turistve qoft në rrafsh apo bjeshk nese ndodhë pickimi nga gjarpri. Ndoshta do të duhej që drejtorati i shëndetsis të jep një përgjigje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - po perpiqem që një pjesë të përgjigjes ta jap me që kemi një marrveshje me Kosova-med për intervenime në shtepi të cilët kanë staf dhe paisje për tju dal qytetarve në ndihmë kudo që mundsohet qarkullimi i autoambulances. Edhe në bjeshkët tona tani më i kemi dy rrugë për Lugë të butë e asfaltuar në tersi dhe për Moikën pjesërisht e asfaltuar 7km të kryera dhe po punohet të kryhet por që ofron mundsi të mirë qarkullimi.

Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pas përfundimit të tregut që ka qenë djë, sot shihen mbeturina në rrugë, kush merret me to dhe a ka mundsi të krijohet një vend i posaçëm për shitsit ambulantor dhe pyetja e dytë nëpër fshatra janë rrit megjat shumë a ka Komuna ndonjë kompani për krastitje dhe lirim të hapsirave publike.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - sa i përket pyetjes së parë është ndermarrja Ambienti që merret me mirëmbajtjen e tregut. Nuk është hera e parë që ngritet ky shqetsim, është edhe inspektori i ambientit që ka mundsi të shqiptoj vrejte dhe denimi dhe në të ardhmen duhet intensifikuar vizitat e tyre gjatë ditës së tregut. Sa i përket megjave apo drunjëve dhe barishtave gjatë rrugëve regjionale është kompania e kontraktuar nga Ministria e cila merret me mirëmbajtjen verore të tyre. Sa ju përket rrugëve lokale edhe në si komunë e kemi një kompani të kontraktuar për mirëmbajtje të rrugëve kryesore por është e pamundur të nderhyjmë në secilin rrugic, andaj shfrytzoj rastin ta falenderoj Imamën e Xhamisë së Rakoshit i cili me një grup vullnetarësh ka nderhy në disa rrugica të lagjeve dhe kanë bërë një punë të mrekullueshme në pastrimin e tyre andaj ftoj të gjithë qytetarët që të vijojnë një praktik të tillë.

Me që nuk ka ju falenderoj në pjesmarrje dhe në kontributin e dhënë në këtë takim dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoj:

11.55

